

**Projekti PROSECO: Konferenca rajonale mbi Protokollin e dytë Shtesë mbi Konventën Evropiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (CETS 182), Tiranë (21-23 Shtator 2009)**

Tiranë 23.09.2009- Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Këshillin e Europës në kuadrin e Projektit "PROSECO, Mbështetje për rrjetin e Prokurorëve në Evropën Jug Lindore" bëri të mundur realizimin e një konferencë rajonale në Tiranë nga datat 21-23 Shtator 2009.

Temat kryesore të diskutuara kishin të bënin me :

1. Nivelin e përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar të vendeve të rajonit, pjesmarrëse të projektit, me Protokollin e dytë Shtesë të Konventës Evropiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (CETS 182 ) si dhe propozimet për ndryshime të ndryshme ligjore me qëllim rritjen e nivelit të përputhshmërisë;
2. Zbatimin praktik të masave të parashikuara nga Protokollin i dytë Shtesë i Konventës Evropiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (CETS 182 ) , duke i ofruar prokurorëve dhe zyrtarëve të Ministrive të Drejtësisë një shpjegim më të mirë mbi mekanizmat e asistencës së ndërsjellë në çështjet penale.

Konferenca mbledhi prokurorë dhe zyrtarë nga ministrinë e drejtësisë të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë, Serbisë , Maqedonisë dhe Bosnje Hercegovinës.